

RAPORTI I NDËRMJETËM NR. 3*
4–13 Qershor 2009

18 Qershor 2009

I. PËRMBLEDHJE

- Veprimtaritë e fushatës zgjedhore kanë vazhduar të zhvillohen gjatë periudhës së raportimit. Megjithëse situata ka vazhduar të jetë përgjithësisht e qetë, në disa zona ka pasur rritje të tensionit. Mosmarrëveshje ka pasur në mënyrë të veçantë për vendosjen e posterave dhe parullave, si dhe çadrave e tendave të fushatës. Një aktivist i Partisë Demokratike (PD) u vra nga një aktivist i Partisë Socialiste (PS) më 12 qershor gjatë një debati për vendosjen e posterave; të dy krahët bënë thirrje për qetësi.
- Qeveria ka vazhduar të përdorë aktivitetet zyrtare në funksion të fushatës. Në disa raste të konfirmuara nga vëzhguesit afatgjatë të Misionit Vëzhgues të OSBE/ODIHR-it, shkollat u mbyllën që nxënësit të merrnin pjesë në këto aktivitete. MVZ-së të OSBE/ODIHR-it vazhdojnë t'i vijjnë aludime se mbi punonjësit e sektorit publik po ushtrohet presion.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar shumicën e procedurave dhe vendimeve të nevojshme për zhvillimin e votimeve dhe numërimin. Megjithatë, shumë Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) nuk po mblidhen ende, ose nuk po mblidhen rregullisht. Caktimi i Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV) është përfunduar në vetëm një të tretën e Zonave të Administrimit Zgjedhor, pasi asnjëra nga katër partitë që duhet të propozojnë anëtarët e KQV-se nuk i ka dorëzuar emrat për të gjitha pozicionet.
- Lista Përfundimtare e Zgjedhësve përmban 3,084,067 qytetarë. PS-ja e ka kontestuar publikisht saktësinë e Listës Përfundimtare të Zgjedhësve, duke thënë se në të ka gabime të llojeve të ndryshme.
- Procesi i pajisjes së çdo votuesi pa pasaportë të vlefshme me kartë identiteti vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes publike. Sipas informacionit të Ministrisë së Brendshme (MB), deri më 12 Qershor u bënë 1.33 milion aplikime dhe u morën nga qytetarët gati 900,000 karta identiteti. MVZ-së të OSBE/ODIHR-it vazhdojnë t'i raportohen probleme teknike dhe organizative. PS-ja pretendon se procesi i aplikimit po bëhet në mënyrë selektive si dhe për pagesa për të marrë kartat e identitetit, në dëm të mbështetësve të saj.
- Monitorimi i mediave nga Misioni Vëzhgues i OSBE/ODIHR-it ka treguar se dy nga pesë kanalet e monitoruara u kushtuan PD-së dhe PS-së sasi pak a shumë të barabarta kohe televizive. Megjithatë, këta operatorë, bashkë me të tjerët vazhduan të tregojnë anshmëri në aspektin e cilësisë (tonit) të pasqyrimin.
- Anëtarët e Bordit të Monitorimit të Medias, të caktuar nga KQZ-ja, kanë shprehur pikëpamje të ndryshme në lidhje me përkufizimin e veprimtarive të Qeverisë dhe atyre të fushatës zgjedhore, që sipas Kodit Zgjedhor duhet të llogariten bashkë me kohën e caktuar për partinë politike përkatëse.

* I vetmi version zyrtar i këtij dokumenti është ai në gjuhën angleze.

- Gjatë periudhës së raportimit, Kolegji Zgjedhor shqyrtoi ankesat ndaj dy vendimeve të KQZ-së. Një kërkesë e PS-së për të rrëzuar një vendim të KQZ-së që miratonte listat e kandidatëve të Partisë Agrare Ambientaliste u hodh poshtë. Kolegji Zgjedhor rrëzoi pjesërisht një tjetër vendim të KQZ-së, i cili përcaktonte partitë që do të mund të merrnin pjesë në hedhjen e shortit për të caktuar anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave.

II. SITUATA POLITIKE DHE FUSHATA

Veprimtaritë e fushatës zgjedhore kanë vazhduar të zhvillohen gjatë periudhës së raportimit dhe udhëheqësit e rëndësishëm politikë kanë bërë udhëtime të shumta duke zhvilluar mitingje nëpër gjithë vendin. Partitë politike kanë ngritur zyra elektorale në shumë pjesë të vendit, megjithëse zhvillimi i fushatës mbetet i kufizuar në disa zona, sidomos në komunitetet rurale.

Situata e fushatës ka qenë përgjithësisht e qetë. Megjithatë, me shtimin e veprimtarive të fushatës, ka pasur edhe një rritje tensioni në disa zona. Mosmarrëveshje ka pasur në mënyrë të veçantë për vendosjen e posterave dhe parullave. Sipas Nenit 79 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit Nr. 14 të KQZ-së, autoritetet lokale duhet të caktojnë hapësira publike për vendosjen e posterave politikë dhe të njoftojnë për këtë subjektet zgjedhore përkatëse. Megjithatë, në shumë raste, partitë nuk janë informuar për hapësirat që u janë caktuar. Kjo ka shkaktuar probleme në disa raste. Për shembull, Lëvizja për Zhvillim Kombëtar në Shkodër e informoi Misionin e OSBE/ODIHR-it se atyre nuk u ishte dhënë informacion i qartë për vendin ku do të mund të vendosnin posterat, pavarësisht kërkesave me shkrim drejtuar administratës së bashkisë, ndërsa policia bashkiake u kërkoi të hiqnin posterat që kishin vendosur. Më 3 qershor dhe më 7 qershor, policia bashkiake e Qytetit të Tiranës hoqi parullat e PD-së në Njësinë Bashkiake Nr. 6, mes kundërshtimeve nëse i takonte kryetarit të bashkisë apo njësisë bashkiake të caktonte ku duheshin vendosur materialet e fushatës. Mosmarrëveshjet për vendosjen e posterave arritën një tjetër dimension më 12 qershor, kur në fshatin Qerret pranë Durrësit, një aktivist i PS-së qëlloi dhe vrau një aktivist të PD-së pas një grindjeje për vendosjen e posterave. Të dyja partitë lëshuan deklarata ku bënë thirrje për qetësi dhe e zbusnin aspektin politik të këtij incidenti.

Edhe çadrat e tendat e fushatës kanë shkaktuar mosmarrëveshje. Më 4 qershor, kryetarja e Njësisë Bashkiake Nr. 6 në Tiranë hoqi një tendë të PS-së jashtë një zyre aplikimi për kartat e identitetit, pas një debati nëse autorizimi duhet të bëhet nga kryetari i bashkisë së qytetit, apo kryetari i njësisë bashkiake. Pas incidentit, ku pati edhe përdorim dhune, tenda u vendos sërish në vend. Në zonën e Shkodrës, tendat e G99-ës u hoqën në Shkodër nga policia bashkiake më 6 qershor, dhe gjithashtu, sipas dëshmive u hoqën në Kopluk dhe Velipojë përkatësisht më 5 dhe 7 qershor. Policia bashkiake e Shkodrës e informoi partinë që këto tenda nuk lejoheshin.

Fushata vazhdon të mbizotërohet pjesërisht nga mosmarrëveshjet për shpërndarjen e kartave të identitetit. Fushata e PS-së është përqendruar në paralajmërimet se zgjedhjet mund të humbasin legjitimitetin në rast se një numër i madh i zgjedhësve mbetet pa karta identiteti dhe nuk janë në gjendje të votojnë, si dhe mbi akuzat që Qeveria ka dhënë informacione false mbi kartat e identitetit dhe pasaportat.

Qeveria ka vazhduar të përdorë aktivitetet zyrtare në funksion të fushatës. Inaugurime të infrastrukturës nga zyrtarë të lartë të qeverisë janë kryer më shpesh seç ndodh jashtë periudhës së fushatës. Për shembull, në inaugurimin nga ana e Kryeministrit të një parku hidro-energjitik pranë Elbasanit më 8 qershor dhe një rrugë në afërsi të Fierit më 10 qershor ishin të pranishme turma të mëdha njerëzish që valëvisnin flamuj të PD-së. Fjalimet e Kryeministrit kishin karakteristikat e fjalimeve të fushatës. Shkollat u mbyllën që nxënësit të merrnin pjesë në këto aktivitete. Shkollat u mbyllën edhe për një miting që po zhvillohej në zonën e Korçës dhe ku merrte pjesë Kryetarja e Parlamentit dhe Zëvendëskryetarja e PD-së, Jozefina Topalli.

MVZ-së së OSBE/ODIHR-it vazhdojnë t'i vijjnë aludime për ushtrim presioni ndaj punonjësve të sektorit publik. Në një incident të verifikuar si të besueshëm, më 9 qershor punonjësve të bashkisë së Peqinit (Qarku i Elbasanit) iu kërkua nga shefat e tyre të merrnin pjesë në një miting të PD-së. Gjatë ditës, bashkia e ndërpreu punën; vëzhguesit afatgjatë të OSBE/ODIHR-it u informuan se punonjësit e bashkisë ishte të zënë me përgatitjet për mitingun. Në një rast presioni, në Gjirokastrë, pronari i një pike karburanti, i cili u gjobit se shiste karburant me cilësi poshtë normave të lejuara, u tha vëzhguesve afatgjatë të OSBE/ODIHR-it se një inspektor e kishte paralajmëruar që ta ndërpriste veprimtarinë e tij në favor të PS-së.

III. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Pas miratimit të shumicës së vendimeve dhe udhëzimeve të nevojshme, KQZ-ja është duke përfunduar një pjesë të rëndësishme të përgatitjeve zgjedhore. Gjatë periudhës së raportimit, KQZ-ja mori, mes të tjerash, vendime për përdorimin e pajisjeve të veçanta që të verbrit të mund të votojnë pa ndihmën e të tjerëve dhe ndërtimin e rrafshëve të pjerrëta krahas shkallëve për 38 ndërtesa qendrash votimi (në të cilat ndodhen mbi 100 qendra votimi) në Tiranë për votuesit paraplegjikë¹. KQZ-ja miratoi edhe manualin për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) në lidhje me procesin e votimit dhe numërimit. Manuali për Grupet e Numërimit (GN) nuk është miratuar ende. Gjithashtu KQZ-ja hodhi short për të vendosur se cilat parti politike do të emëronin anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit për secilën Vend të Numërimit të Votave (VNV).

Situata nuk është kaq inkurajuese për punën e 66 KZAZ-ve, shumica e të cilave nuk po mblidhen, ose nuk po mblidhen rregullisht, sipas raportimit të vëzhguesve afatgjatë të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it. Më 11 qershor, Kreu i Departamentit të Komisioneve Zgjedhore në KQZ informoi KQZ-në se në dhjetë KZAZ një ose më shumë anëtarë ose kishin dhënë dorëheqjen, ose nuk merrnin pjesë në punimet e KZAZ-së. Disa anëtarë të KZAZ-ve të emëruar nga PS-ja dhe që kanë dhënë dorëheqjen nuk janë liruar formalisht nga detyra dhe në seancat e KQZ-së nuk është diskutuar ndonjë kërkesë formale e PS-së për të zëvendësuar anëtarët e KZAZ-ve që nga koha kur Misioni i OSBE/ODIHR-it filloi të ishte e pranishme gjatë tyre. Më 11 qershor, kryetari i KQZ-së i tha përfaqësuesit të autorizuar të PS-së në KQZ se ky institucion do t'i pranonte emërimet e PS-së vetëm nëse do të përmbusheshin kushtet ligjore që 30 për qind të anëtarëve në rang vendi të ishin nga secila gjini. Për ta përmbushur kërkesën, PS-ja duhet të emërojë edhe 12 gra si anëtare të KZAZ-ve.

Procesi i emërimit të anëtarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV) nuk ka përfunduar, edhe pas mbarimit të afatit për formimin e KQV-ve, i cili ishte më 8 qershor. Më 10 qershor, vetëm një e treta e 66 KZAZ-ve e kishte përfunduar caktimin e të gjitha KQV-ve nën juridiksionin e tyre. Asnjë nga katër partitë politike që duhet të emërojnë anëtarët e KQV-ve (PD, PS, PR dhe PSD) nuk i kanë dorëzuar emërimet për të gjitha pozicionet që duhet të plotësojnë, megjithëse afati ligjor për këto emërimet ishte 14 maji. Gjatë mbledhjes së KQZ-së më 11 qershor, Kryetari dhe Zëvendëskryetarja e KQZ-së i kritikuan partitë për mosrespektim të ligjit, por KQZ-ja nuk ka gjetur ende zgjidhje për problemin e mungesës së emërimeve.

Përgatitjet teknike për ngritjen dhe pajisjen me materiale të Vendeve të Numërimit të Votave (VNV) tashmë janë drejt përfundimit. KQZ-ja bëri një prezantim publik të sistemit monitorues me anë të kamerave, i cili do të përdoret në VNV dhe brenda periudhës së raportimit arriti të instalojë këto kamera në gjysmën e 66 VNV-ve. Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit

¹ Për qendrat e votimit në pjesën tjetër të vendit nuk u mor një vendim i ngjashëm, pasi kryetarët e bashkive dhe komunave nuk arritën të dorëzonin në KQZ listat përkatëse të votuesve që kishin nevojë për ndihmë. 38 vendet në Tiranë u përzgjedhën me ndihmën e Shoqatës së Njerëzve me Aftësi të Kufizuara.

po kryen testimet përfundimtare të programeve kompjuterike që do të përdoren për të transmetuar dhe llogaritur rezultatet e zgjedhjeve.

Printimi i fletëve të votimit filloi më 8 qershor dhe fletët e votimit priten të mbërrijnë në KQZ në fund të javës para ditës së votimeve. Paketimi i fletëve të votimit veçmas për çdo qendër votimi pritet të kërkojë shumë kohë, duke pasur parasysh faktin se Kodi Zgjedhor parashikon dërgimin në çdo Qendër Votimi të një numri fletësh votimi të barabartë me numrin e zgjedhësve të qendrës në fjalë, plus 2% fletë rezervë. KQZ-ja ka deklaruar se gjithsej që do të printohen, 3,145,748 fletë votimi.

IV. REGJISTRIMI DHE IDENTIFIKIMI I ZGJEDHËSVE

Më 4 qershor, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) dërgoi në KQZ Listën Përfundimtare të Zgjedhësve (LPZ), në të cilën gjenden 3.084.067 zgjedhës. Megjithëse pjesa më e madhe e LPZ-ve është afishuar në vendin përkatës në qendrat e votimit, siç kërkohet nga Kodi Zgjedhor, disa nga vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it kanë raportuar se disa KZAZ nuk e kanë përmbushur dot këtë detyrë një javë pas afatit të paracaktuar të datës 3 qershor, kjo në sajë të vështirësive logjistike. Raste të tilla janë raportuar nga rajonet e Peshkopisë, Elbasanit, Fierit dhe Beratit.

Edhe afati i datës 7 qershor për ngritjen e qendrave të veçanta të votimit në spitale dhe institucione shëndetësore ka kaluar. Megjithatë, procedura e heqjes së emrave të zgjedhësve në këto qendra nga lista e zonës së tyre zgjedhore duhet bashkërenduar nga Ministria e Brendshme (MB) në bashkëpunim me KQZ-në.

Pas marrjes së versionit elektronik të LPZ-së, Partia Socialiste kontestoi cilësinë e listave. PS-ja gjeti 5.186 raste të cilat bënin pjesë në kategorinë e regjistrimeve të shumëfishta; 516 emra njerëzish të cilët ose e kishin lënë vetë ose u ishte hequr nënshtetësia shqiptare; 2,799 emra njerëzish të cilët, sipas regjistrave, janë më shumë se 110 vjeç; dhe 98 raste me gabime tipografike të cilat i bëjnë emrat e zgjedhësve të palexueshëm dhe, si rrjedhojë, ka mundësi edhe të humbasin të drejtën e votës. Drejtori i Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) konfirmoi se këto shifra ishin të sakta. Megjithatë Ligji për Gjendjen Civile ndalon fshirjen e emrave të njerëzve nga regjistri nëse nuk raportohet vdekja e tyre. Po ashtu, programi kompjuterik që përdoret për mirëmbajtjen e regjistrat nuk lejon shkrirjen e më shumë se dy rasteve në një emër të vetëm, gjë që për momentin e bën të pamundur shkrirjen dhe vendosjen në një të rasteve të shumëfishta. Edhe pse politikanët janë shprehur publikisht se në listën e zgjedhësve gjenden dhjetëra mijëra pasaktësi, këto deklarata nuk duket të mbështeten nga numri i kufizuar i rasteve të raportuara.

Fushata për të pajisur të gjithë zgjedhësit e regjistruar pa pasaportë të vlefshme me karta identiteti vazhdon të jetë qendra e vëmendjes së publikut me raportime për dështime me natyrë teknike dhe organizative. Disa qendra aplikimi vazhdojnë të kenë ndërprerje energjie apo interneti. Më 28 maj dhe 6 qershor Ministria e Brendshme nxori dy urdhra të ndryshëm për oraret e punës së Zyrrave të Gjendjes Civile. Që prej datës 6 qershor, Zyrrat e Gjendjes Civile dhe qendrat e aplikimit duhet të rrinë hapur 14 orë në ditë. Vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it raportuan se punonjësit e qendrave të aplikimit nuk kishin gjithnjë njohuri për ndryshimet e orarit të punës.

Në dy qendra aplikimi (komunat e Hor-Vranishtit dhe Poshnjës), problemet teknike bënë që fotografitë e aplikuesve të ishin të një cilësie aq të dobët, sa aplikuesve iu desh të ktheheshin sërish në qendrat e aplikimit. Në Bashkinë e Korçës, vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it raportuan një rast të dhënies së një çertifikate lindjeje false, këto çertifikata

duhen në mënyrë që të vërtetohet identiteti i aplikuesit. Ky rast u ndoq nga Policia e Shtetit, e cila filloi edhe kallëzimin penal. Në disa raste të vëzhguara, pati edhe institucione arsimore që ishin përfshirë për të kontrolluar nëse kishin aplikuar qytetarë të ndryshëm për karta, apo jo. Drejtoria Arsimore e Rrethit Shkodër u dha urdhër nxënësve që t'i jepnin shkollës numrin e kartës të identitetit që kishin marrë prindërit e tyre. Vëzhguesit afatgjatë të OSBE/ODIHR-it janë informuar se rektori i një universiteti e kushtëzoi hyrjen në provime apo dhënien e bursave mujore me paraqitjen e pasaportës apo një prove që të vërtetojë aplikimin për kartë identiteti.

Partia Socialiste vazhdon të thotë se skemat që lejojnë rimbursimin apo uljen e çmimit për grupe të caktuara të popullsisë aplikohen në mënyrë selektive duke favorizuar mbështetësit e PD-së, ndërkohë që zgjedhësit e PS-së janë të detyruar të paguajnë çmimin maksimal prej 1,200 Lekësh (afërsisht 9 Euro) për një kartë identiteti. Për më tepër, PS-ja pretendon se problemet teknike sajohen nga mbështetësit e PD-së në mënyrë që të ngadalësojnë ose të shtyjnë mbështetësit e PS-së të aplikojnë për kartë identiteti. Vëzhguesit afatgjatë të Misionit të OSBE/ODIHR kanë marrë pretendime të shumta në lidhje me përfshirjen e panevojshme të aktivistëve të PD-së në këtë proces. Ata e verifikuan këtë në qarkun e Vlorës dhe Korçës.

Që nga fundi i muajit maj, Ministria e Brendshme nuk ka i ka dhënë PS-së të dhënat e fundit mbi numrin e votuesve pa pasaportë të cilët kanë aplikuar për kartë identiteti. Megjithëse Ministria nuk është e detyruar t'i japë këto shifra, ajo e ka bërë më parë një gjë të tillë në disa raste. Ministria u shpreh se këto shifra do të bëhen publike pranë datës së mbylljes së aplikimeve për kartë identiteti (18 Qershor).

Sipas informacionit të marrë nga MB deri më 12 Qershor janë bërë 1,333,463 aplikime. Nga 1,218,393 karta identiteti të prodhuara, 892,778 janë tërhequr nga aplikuesit. Megjithëse gjatë periudhës 6-13 Qershor numri mesatar ditor i tërheqjes së kartave të identitetit është rritur deri në afërsisht 22,000 dhe e tejkalon ndjeshëm numrin mesatar të aplikimeve (rreth 12,500), ky numër është ende më i ulët se numri mesatar ditor që do të duhet të arrihej me qëllim që të gjithë zgjedhësit pa pasaportë të mund t'i marrin kartat para ditës së zgjedhjeve. Për të përshpejtuar procesin, Ministria e Brendshme ka filluar një fushatë në media, duke këshilluar aplikuesit të tërheqin kartat e identitetit sa më shpejt të jetë e mundur.

V. MEDIA

Nenet 81.3 dhe 84.2 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë se koha e pasqyrimin të veprimtarive qeveritare që lidhen me fushatën zgjedhore përfshihet në kohën e partisë së cilës i përket titullari që zhvillon veprimtarinë. Kodi Zgjedhor nuk përcakton më tej se cilat aktivitete të Qeverisë lidhen me fushatën zgjedhore. Në këto kushte, Bordi i Monitorimit të Medias (BMM), i emëruar nga KQZ-ja, i cili monitoron zbatimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor që kanë lidhje me median, është i lirë të bëjë interpretimin e tij.

Në raportin e bërë nga BMM për periudhën 28 Maj–8 Qershor, disa aktivitete gjatë të cilave Kryeministri bënte fushatë duke qenë në funksionin e tij institucional u konsideruan si aktivitete institucionale nga 4 anëtarët e BMM të caktuar në detyrë nga anëtarët e KQZ-së të emëruar nga shumica e parlamentare. Tre anëtarët e tjerë të BMM i vlerësuan këto dalje në publik si të lidhura më fushatën. Vlerësimi i ndryshëm nëse këto aktivitete ishin vetëm institucionale ose të lidhura me fushatën ka një ndikim të rëndësishëm në kohën e përgjithshme të transmetimeve kushtuar mbulimit të fushatave të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike si dhe nëse operatorët mediatikë respektojnë Nenet 81.3 dhe 84.2 të Kodit Zgjedhor. Sipas rekomandimeve

ndërkombëtare, autoritetet publike nuk duhet të trajtohen në mënyrë të privilegjuar gjatë edicioneve informative dhe programeve për çështjet publike që mbulojnë fushatën zgjedhore.²

Gjithashtu BMM raporton se, megjithëse disa media kanë treguar njëanshmëri për Partinë Demokratike dhe Partinë Socialiste, një numër i konsiderueshëm i mediave të monitoruara kanë mbuluar relativisht njësoj partitë kryesore gjatë edicioneve informative. BMM theksoi se meqenëse nuk ka parregullsi të mëdha dhe transmetuesit kanë treguar tendencën për të balancuar minutazhin kushtuar subjekteve elektorale, çdo pjesë e mbetur do të rregullohet gjatë periudhës së mbetur të fushatës dhe brenda kohës së caktuar për çdo parti.

Monitorimi i medias nga ana e MVZ-së së OSCE/ODIHR për periudhën që nga fillimi i fushatës zyrtare më 28 Maj deri më 10 Qershor tregon se dy nga pesë operatorët e monitoruar u kanë vënë në dispozicion dy partive kryesore një sasi kohe të barabartë transmetimi. Operatori publik TVSH i ka dhënë 57% të kohës Partisë Demokratike dhe 27% Partisë Socialiste. News 24 ka vënë në dispozicion 40% të kohës për Partinë Demokratike dhe 41% për Partinë Socialiste, ndërsa Top Channel i ka dhënë 37% të kohës Partisë Demokratike dhe 34% Partisë Socialiste. Nga Vizion Plus, Partisë Demokratike iu dha 46% e kohës së pasqyrit të fushatës dhe Partisë Socialiste 32%. TV Klan pasqyroi 58% Partinë Demokratike dhe 25% Partinë Socialiste.³

Megjithëse u ka vënë në dispozicion kohë të barabartë dy partive kryesore, News 24 ka favorizuar Partinë Socialiste për sa i përket tonit të përdorur. Gjashtëdhjetë e katër përqind të kohës së transmetimit të Partisë Socialiste kishte tone pozitive, ndërsa 39% e kohës së Partisë Demokratike kishte tone negative. Top Channel favorizonte Partinë Socialiste me 58% pasqyrim pozitiv, ndërsa Partia Demokratike kishte 39% pasqyrim negativ. Vizion Plus ka pasqyruar me tone negative Partinë Demokratike (46% negativ), pasqyrimi i Partisë Socialiste kishte në përgjithësi tone asnjëse (56%). Tek TV Klan, 85% e kohës kushtuar Partisë Demokratike kishte tone pozitive, siç ishte pozitive edhe 59% e kohës së Partisë Socialiste. Tek TVSH, pjesa më e madhe e pasqyrit të Partisë Demokratike (77%) dhe Partisë Socialiste (58%) kishte tone pozitive, kryesisht si pasojë e mungesës së komenteve të gazetarëve dhe pasqyrit të aktiviteteve të fushatës nga vetë partitë politike. Asnjë nga operatorët e monitoruar nuk ka respektuar Nenin 81.1 dhe Nenin 84.2 të Kodit Zgjedhor në lidhje me pasqyrimin e aktiviteteve të partive të vogla parlamentare.

VI. ANKIM NË RRUGË ADMINISTRATIVE OSE GJYQËSORE

Me 6 Qershor, Kolegji Zgjedhor shqyrtoi të bashkuara kërkesat ankimore të Partisë Socialiste dhe Partisë Socialdemokrate kundër vendimit të KQZ-së i cili përcaktonte partitë parlamentare që kanë të drejtë të marrin pjesë në hedhjen e shortit për të caktuar partitë që do të emërojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupit të Numërimit. Partia Socialiste kundërshtoi përfshirjen e Partisë Demokristiane (PDK) dhe Partisë së Bashkimit të Drejtave të Njeriut (PBDNJ) në listën e partive të opozitës parlamentare.

Kodi Zgjedhor nuk parashikon kritere të veçanta për dallimin e partive të shumicës dhe të opozitës; prandaj KQZ i dërgoi një kërkesë Parlamentit të përcaktonte se cilat parti i përkasin shumicës dhe cilat opozitës. Përgjigjja e dhënë nga Parlamenti përfshinte vetëm partitë e shumicës. KQZ i dërgoi një shkresë të dytë Parlamentit duke kërkuar të përcaktonte se cilat parti i përkasin opozitës. Parlamenti u përgjigj që tashmë PBDNJ-ja nuk është pjesë e shumicës në

² Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Rekomandimi Nr. R (99) 15 i Komitetit të Ministrave për Vendet Anëtare, në lidhje me Masat për Pasqyrimin Mediatik të Fushatës Zgjedhore, (hartuar nga Komiteti i Ministrave më 9 shtator 1999, gjatë takimit të 678-të të Zëvendësministrave).

³ Shifrat në këtë seksion i referohen pasqyrit të subjekteve politike në lajme dhe programe të tjera informuese. Shifrat nuk përfshijnë pasqyrimin e detyrave të tyre institucionale.

pushtet; ndërsa për sa i përket partive që i përkasin opozitës, përgjigja thoshte se partitë nuk janë të detyruara nga rregullorja e Kuvendit të deklarojnë se ku bëjnë pjesë, prandaj i ngelet KQZ-së të shqyrtojë dhe të vendosë për këtë çështje.

KQZ-ja ra dakord të marrë një vendim pas regjistrimit të koalicioneve zgjedhore, sepse mendohet që pozicioni i partive do të jetë më i qartë në këtë fazë. Partia Socialiste e kundërshtonte këtë arsyetim duke thënë se PDK-ja dhe PBDNJ-ja kishin qenë pjesë e qeverisë që në fillim të mandatit të Kuvendit. PDK-ja mbështeti pretendimet e Partisë Socialiste duke deklaruar se ajo i përket shumicës, meqenëse gjithmonë ka mbështetur Qeverinë. Kolegji Zgjedhor pranoi plotësisht kërkesën ankimore të bërë nga Partia Socialdemokrate dhe pjesërisht atë të bërë nga Partia Socialiste. Si rrjedhojë, PDK mori pjesë në hedhjen e shortit si parti e shumicës, ndërsa PBDNJ u konsiderua parti opozitare.

Partia Socialiste bëri një tjetër ankimim duke kërkuar shfuqizimin e Vendimit të KQZ-së i cili miratonte listën e kandidatëve të Partisë Agrare Ambientaliste (PAA). PAA-ja po kandidon në zgjedhje brenda koalicionit Aleanca për Ndryshim të kryesuar nga Partia Demokratike. Partia Socialiste pretendoi se dy nga listat shumëemërore të PAA-së (për Fierin dhe Shkodrën) nuk i përmbushnin kriteret gjinore të parashikuara nga Neni 67 i Kodit Zgjedhor, edhe pasi listat u ridorëzuan nga PAA-ja pas kërkesës së KQZ-së për korrigjime. PS-ja shtoi se korrigjimet në lista ishin bërë në mënyrë jozyrtare dhe pas miratimit përfundimtar nga KQZ-ja, çka do të përbente shkelje të Nenit 73 të Kodit Zgjedhor. Kërkesa ankimore e PS-së jo vetëm që nuk përmbushte bazat ligjore, por nuk e justifikonte objektin e saj, pasi parregullsitë e vogla të pretenduara në dy listat shumëemërore nuk mjaftojnë për të arsyetuar kërkesën për të përjashtuar një parti nga gara zgjedhore. Kolegji Zgjedhor vendosi të lërë në fuqi vendimin e KQZ-së.

Sipas Nenit 158.6 të Kodit Zgjedhor, Kolegji Zgjedhor është i detyruar të zbardhë vendimin jo më vonë se tri ditë nga data e dhënies së tij. Megjithatë, deri më tani, zbardhjet e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor janë bërë nga pesë deri në dhjetë ditë pas marrjes së tyre. Kjo praktikë përbën problem, sidomos në rastet kur shfuqizohet një vendim i KQZ-së dhe kjo e fundit duhet të marrë një vendim tjetër pa u njohur me arsyetimin e Kolegjit Zgjedhor.

Deri tani në KQZ nuk është depozituar asnjë ankesë.

VII. VËZHguesIT VENDAS

KQZ ka akredituar 181 vëzhgues nga Forumi Shqiptar i të Drejtave Ndërkombëtare të Njeriut duke e çuar në tre numrin e përgjithshëm të organizatave të vëzhguesve vendas jopartiakë deri në fund të periudhës së raportimit. Kërkesa për akreditim e “Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë”, një koalicion i përbërë nga shtatë OJF⁴ që planifikojnë të vëzhgojnë zgjedhjet me 135 vëzhgues afatgjatë dhe mbi 2,500 vëzhgues afatshkurtër u kthye mbrapsht nga KQZ-ja për korrigjim. Ish-kryetari i lëvizjes *MJAFT!*, një nga OJF-të pjesë e koalicionit, është edhe Kryetar i partisë G99, çka ka sjellë dyshime për paanshmërinë e koalicionit. Dy OJF Shqiptare, ECA dhe KRIIK-Albania do të kryejnë një llogaritje paralele të votave në të 66 VNV-të.

VIII. VEPRIMtarITË E MVZ-SË SË OSBE/ODIHR -IT

Gjatë periudhës së raportimit, Misioni Vëzhgues i OSBE/ODIHR-it vazhdoi veprimtaritë e tij normale. Kreu i Misionit dhe anëtarë të tjerë të ekipit qendror vazhduan takimet me KQZ-në, zyrtarë të shtetit, përfaqësues të partive, zyrtarë të gjykatave, përfaqësues të mediave dhe

⁴ Koalicioni i Vëzhguesve Vendas përbëhet nga këto organizata: Shoqata për Kulturë Demokratike, Qendra për Gratë dhe Fëmijët-Kombinat, KRIIK-Albania, Lëvizja Mjaft, Qendra e Gruas për Veprim Global, Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit Zgjedhor dhe Partners-Albania.

shoqërisë civile, si dhe misionet diplomatike. Vëzhguesit afatgjatë të Misionit Vëzhgues të OSBE/ODIHR-it, të vendosur në të gjithë vendin, vazhdojnë të vëzhgojnë fushatën dhe përgatitjet zgjedhore nëpër zona dhe po përgatiten për ardhjen e vëzhguesve afatshkurtër. Më 5 qershor u zhvillua një takim informues për anëtarët e komunitetit diplomatik dhe organizatat ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë.